

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fllanza Kadiu, kryetare kolegji, Mejreme Memaj e Fillim Skoro, anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale të të akuzuarve: H.K., nga fshati ... rrethi i Hasit, Republika e Shqipërisë, për veprat penale vrasje e rendë në tentativë, parashikuar me nenin 147 pika 4 dhe 10 lidhur me nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës(KPK), tri veprave penale të grabitjes, parashikuar me nenin 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, parashikuar me nenin 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK, lëndim i rëndë trupor, parashikuar me nenin 189 par.1 nënpar.1 të KPRK dhe dy veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 374 par.1 të KPK, dhe F.B., nga Gjakova, rruga "...", nr.9, për veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, parashikuar me nenin 316 par.3 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorit Themelor në Gjakovë, ato të mbrojtësit të të akuzuarit avokatit B.H., atë të dëmtuarit R.K., dhe përgjigjes në ankesën e Prokurorit të të akuzuarit F.B., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.186/2013 datë 4.07.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me 21 tetor 2014, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. Me aprovimin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, dhe detyrimisht aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.186/2013 datë 4.07.2014, ndryshohet sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe vendimit për dënim ashtu që kjo Gjykatë gjen se në veprimet e të akuzuarit H.K. të përshkruara në pikën V, VI dhe VII qëndrojnë vetëm elementet e një veprë penale të grabitjes, nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK, dhe kjo Gjykatë këtë të akuzuar për veprën penale të lartcekur e gjykon me 5(pesë ) vite burgim, ndërsa, duke ia marrë si të vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6(gjashtë) viteve për veprën penale nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit – neni 147 pika 4 e 10 lidhur me nenin 20 të KPK, dhe dënimet me burgim në kohëzgjatje prej nga 3(tri) viteve për dy veprat penale të grabitjes, nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK nën pikën III e IV të dispozitivit të aktgjykimit, konform dispozitës së nenit 80 të KPK e

gjykon me dënim unik burgu në kohëzgjatje prej 15(pesëmbëdhjetë) viteve, në të cilin do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 14.08.2012 e tutje.

**II.** Me rastin e ankesave e detyrimisht aktgjykimi i lartcekur përkitazi me veprat penale nën pikën II e VIII të dispozitivit të aktgjykimit -mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 374 par.1 të KPRK ndryshohet ashtu që kjo Gjykatë konform dispozitës së nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPP e refuzon akuzën për shkak se prokurori ka heq dorë nga akuza për këto vepra penale.

**III.** Ankesa e Prokurorit sa i përket pjesës liruese përkitazi me të akuzuarin F.B. dhe ajo e mbrojtësit të të akuzuarit H.K. refuzohen si të pabazuara, ajo e të dëmtuarit R.K. është e palejuar, kurse ankesa e të akuzuarit është e pasafatshme.

**IV.** Aktgjykimi i lartcekur në pjesën refuzuese ngel i pashqyrtuar.

### **A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Gjakovë me aktgjykimin P.nr.186/2013 datë 4.07.2014, të akuzuarin H.K., e ka shpall fajtor për veprat penale: vrasje e rëndë në tentativë, parashikuar me nenin 147 pika 4 dhe 10 lidhur me nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës(KPK), tri veprave penale të grabitjes, parashikuar me nenin 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, parashikuar me nenin 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK, lëndim i rëndë trupor, parashikuar me nenin 189 par.1 nënpar.1 të KPRK dhe dy vepra penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 374 par.1 të KPK, dhe pasi që ia ka caktuar dënimet me burgim për secilën vepër dhe atë: për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë, nga neni 147 pika 4 e 10 lidhur me nenin 20 të KPK dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6(gjashtë) viteve, për tri veprat penale të grabitjes, nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK dënimet me burgim në kohëzgjatje prej nga 3(tri) vite, për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm dënimin me burgim me 6(gjashtë) muaj burgim, për veprën penale lëndim i rëndë trupor dënimin me 1(një) vit burgim, për dy veprat penale të armëmbajtjes pa leje, nga neni 374 par.1 të KPK dënimet me nga 6(gjashtë) muaj burgim, konform dispozitës së nenit 80 të KPK e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 12(dymbëdhjetë) viteve, në të cilin ia ka llogaritur edhe kohen e kaluar në paraburgim prej 14.08.2012 e tutje. Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil. I akuzuari është obliguar që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 80€, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 600€. Ndaj të akuzuarit H.K., konform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPP është refuzuar akuza për një vepër penale të grabitjes, nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK e që më akuzë është ngarkuar se e ka kryer në kafenenë e të dëmtuarit E.P. në fshatin ..., për shkak se Prokurori ka heq dorë nga ndjekja penale. Me të njëjtin aktgjykim i akuzuari F.B. konform dispozitës së nenit 364 par.1 pika 1.1 të KPP është liruar nga akuza për veprën penale pengimi i personit zyrtar

në kryerjen e detyrave zyrtare, parashikuar me nenin 316 par.3 të KPK për shkak se nuk është provuar se e ka kryer këtë vepër penale.

Kundër këtij aktgjykimi kanë paraqitur ankesa:

-Prokurori Themelor në Gjakovë në pjesën gjykuese vetëm sa i përket vendimit për dënim, kurse në pjesën liruese për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit H.K. për veprat penale për të cilat është shpall fajtor ti shqipton dënim me të mendë, kurse i akuzuari F.B. të shpallet fajtor për veprën penale për të cilën është liruar nga akuzua dhe ti shqiptohet dënim sipas ligjit;

- mbrojtësi i të akuzuarit H.K., avokati B.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza apo të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim;

-i dëmtuari R.K., vetëm për shkak të vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit për veprën penale lëndim i mendë trupor, nga neni 189 par.1 nënpar.1 të KPK ti shqiptoj dënim me burgim me të mendë;

- ndaj ankesës së Prokurorit Themelor në Gjakovë është përgjigjur i akuzuari F.B. me propozim që ankesa e Prokurorit në pjesën liruese të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i kundërshtuar në këtë pjesë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës për seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPP i njoftoj palët. Në seancë prezantoi i akuzuari H.K., kurse mbrojtësi i tij avokati B.H., Prokurori i Apelit dhe të dëmtuarit edhe pse të njoftuar me rregull nuk morën pjesë në seancë. Meqë i akuzuari gjendet në paraburgim Gjykata me pëlqimin e të akuzuarit ia caktoj mbrojtësin sipas detyrës zyrtare avokatin H.R., i cili mbështeti ankesën me shkrim, kurse i akuzuari mbështeti mbrojtësin. Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/1.nr.453/2014 datë 18.09.2014, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Themelor dhe ajo e të dëmtuarit të aprovohet, ashtu që të akuzuarit H. t'i shqiptohet një dënim me i mendë me burgim, kurse i akuzuari F.B. të shpallet fajtor dhe ndaj tij të shqiptohet dënim konform dispozitave ligjore, kurse ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Kolegji i kësaj Gjykate në seancën e kolegjit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, studimit të aktgjykimit të kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesa gjeti:

-ankesa e Prokurorit është e bazuar sa i përket vendimit për dënim përkitazi me të akuzuarin H.K., aktgjykimi i kundërshtuar detyrimisht duhet ndryshuar sa i përket cilësimit juridik të veprave penale sikurse në pikën I të këtij dispozitivi, dhe veprave penale të armbajtës pa leje si në pikën II, ankesa e prokurorit për pjesën liruese dhe ajo mbrojtësit të

të akuzuarit janë të pabazuara, ankesa e të dëmtuarit është e palejuar, kurse ajo e të akuzuarit e pasafatshme.

## I

### **I. Vlerësimet e kësaj Gjykate përkitazi me pjesën dënuese të aktgjykimit të shkallës së parë.**

a). Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën gjykuese nga Prokurori Themelor nuk kundërshtohet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit H.K. sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk konkretizon se cila dispozitë është shkelur por vetëm thekson se aktgjykimi nuk përmban arsye të mjaftueshme për çështjet kryesore, kurse arsyet e dhëna janë në kundërshtim me përmbajtjen e provave dhe deponimeve të dhëna në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, pra, aludohet në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 të KPP, ndërsa, nuk jep arsye se ku qëndrojnë këto shkelje, por, në këtë drejtim i referohet gjendjes faktike dhe aplikimit të ligjit penal.

Edhe pse mbrojtësi i të akuzuarit këtë bazë ankimore nuk e arsyeton kjo Gjykatë e vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në këtë drejtim dhe gjeti se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë dhe as që ka shkelje tjera të cilat kjo Gjykatë i verën sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij. Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i qartë dhe nuk është kundërthënës me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprave penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit.

### **b) pretendimet përkitazi me gjendjen faktike**

Po ashtu Prokurori aktgjykimin e kundërshtuar në pjesën gjykuese nuk e konteston përkitazi me gjendjen faktike, kurse, mbrojtësi i të akuzuarit përkitazi me gjendjen faktike me ankesë konteston mënyrën si janë vlerësuar provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe konkludimin e gjykatës në bazë të këtyre provave. Pretendon se nga provat e administruara nuk mund të konkludohet se i mbrojturi i tij është kryerës i veprave penale, veçanërisht mbrojtësi me ankesë pretendon se gjykata me asnjë provë nuk i ka vërtetuar veprimet inkriminuese të të akuzuarit sa i përket veprës penale të vrasjes së rendë, parashikuar me nenin 147 pika 4 e 10 lidhur me nenin 20 të KPK. Kështu, sipas ankesës nuk është gjetur asnjë provë materiale në vendin e ngjarjes që do të vërtetonte mjetin me të cilin është kryer vepra, nuk është gjetur arma dhe nuk ka prova të besueshme që vërtetojnë me saktësi se ai është kryerës i kësaj vepre penale. Sipas ankesës edhe nën supozimin se në veprimet e të akuzuarit ka elemente inkriminuese atëherë nuk mund të behet fjalë për veprën penale të vrasjes së rendë në tentativë, ngase duke pasur parasysh pozitën, distancën, mënyrën dhe sjelljen e të akuzuarit si dhe mos shkaktimin e pasojave, s'ka të

lënduar e as dëm material në automjetin zyrtarë del qartë se nuk mund të behet fjalë për veprën penale të vrasjes së rendë në tentativë, por mund të behet fjalë për veprën penale sulm ndaj personave zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtarë nga neni 317 par.1 të KPK, madje as nga dëshmitë e të dëmtuarve nuk rezulton se ekzekutor i kësaj vepre penale është i akuzuari ngase ata as që kanë mundur ta identifikojnë, ndërsa për ta sqaruar këtë rast më se miri gjykata është dashtë ta dëgjojë dëshmitarin N.K. e jo të lexohet deklarata e tij. Ndërsa, sa i përket tri veprave penale te grabitjes të kryera me 14.03.2012, në afërsi të lumit Dri-Ura e Shenjtë, rreth orës 22:00, tek restoranti "...", ne fshatin ... rreth orës 23:00 dhe restorantin "...", në fshatin ... rreth orës 23:30 sipas mbrojtjes i akuzuari fare nuk ka qenë bashkëpjesëmarrës ngase i njëjti në këtë datë nuk ka qenë në Kosovë, por ishte në Shqipëri duke vijuar mësimet në universitetin e Vlorës për çka edhe ka prezantuar edhe vërtetimin e këtij Fakulteti. Përveç kësaj sipas mbrojtjes asnjë nga dëshmitarët e dëgjuar lidhur me këtë rast nuk e kanë identifikuar të akuzuarin.

Duke i vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtësit në këtë drejtim kjo gjykatë vlerëson se ato janë të pabazuara.

Sipas dëshmisë së dëshmitarit N.P. te dhënë në Prokurori( deklarata e të cilit në shqyrtimin gjyqësor është lexuar), del se i akuzuari me familjen e këtij dëshmitari kanë pas raporte shoqërore. Me 25.09.2010, i akuzuari kishte qenë në shtëpinë e tij në fshatin ... si mysafirë por, nuk kishte qëndruar, ngase ishte nisur për në fshatin ... të Hasit, meqë i akuzuari nuk do të qëndronte në shtëpinë e dëshmitarit, vet ishte nisur për Prishtinë, kurse e kishte thirre të akuzuarin F.B. dhe e kishte lutur që të akuzuarin H. ta dërgonte ne fshatin ..., pasi që është nisur për Prishtinë gjatë rrugës në Fushë Kosovë e kishin marrë në telefon nga Stacioni Policor në Gjakovë dhe kishin kërkuar nga ai që të lajmërohet në polici. Sipas këtij dëshmitari gjatë kohës sa ka qëndruar H.i në shtëpi atë nuk e kanë parë anëtarët e tjerë të familjes, kurse gruas së vëllait të tij nuk i ka treguar se kush është. Nga dëshmia e dëshmitarit U.F. Gj.-vëllait të N. del se ky dëshmitar gjatë ditës me 25.09.2010 ka qenë në shtëpi atë ditë ka vjel molla dhe nuk ka ditë se në shtëpi kanë pas mysafirë, ndërsa në orët e mbrëmjes rreth 22:30 derisa ka qenë duke fjetur shtëpia i është rrethuar nga policia të cilët e kanë maltretuar, ndërsa vetëm në stacionin policor ka kuptuar së në shtëpinë e tij ka qenë një mysafir nga Shqipëria. Sipas dëshmisë së të dëmtuarve të këtij rasti F.N., A.I. e B.A. del se me 25.09.2010 rreth orës 22:00 kanë qenë në njësinë e patrullimit sipas planit operativ "goditje e hekur", më qëllim të parandalimit të gjerave negativë ne shoqëri. Natën kritike pasi që i është dhënë shenjë që të ndalet automjetit të cilin e ka vozitur i akuzuari F.B. që vinte nga fshati ... automjeti nuk është ndalur, por ka vazhduar edhe 5-6m dhe është ndalur, nga automjeti ka dalë pasagjeri dhe ka filluar të ikë dhe të gjuaj në drejtim të tyre. Sipas këtyre dëshmitareve në momentin kur i akuzuari ka filluar të gjuaj afërsia në mes tyre ka qenë 6-7m, ka shtënë disa herë, por fillimisht ka gjuajtur dy herë një plumb pas tjetrit të cilat të shtëna kanë qenë me te rrezikshme pasi që kanë qenë ballë për ballë me të, por për fatin e tyre predhat nuk i kanë kapur, kurse të shtënat tjera kanë qenë në drejtim të tyre por në lëvizje, me vonë kanë kuptuar se behej fjalë për një person nga Shqipëria. Edhe sipas mbrojtjes së të akuzuarit F.B. rezulton se pasi që ai e ka ndalur automjetin i akuzuari ka gjuajtur me armë në drejtim të policëve 5-6 herë dhe pastaj është futur ne pyll.

Duke pas parasysh këtë gjendje të çështjes, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate dëgjimi i dëshmitarit N.P. në shqyrtimin gjyqësor nuk do të vërtetonte diç me shume në këtë drejtim, ngase, ai nuk e mohon faktin se ditën kritike i akuzuari ishte në shtëpinë e tij dhe se e kishte lutur F.B.n që ta dërgonte në fshatin ..., përveç kësaj leximin e deklaratës së tij në shqyrtimin gjyqësor mbrojtësi nuk e ka kundërshtuar, ndërsa, pa marrë parasysh se nuk ka prova materiale që i vërtetojnë veprimet inkriminuese të të akuzuarit, nuk është gjetur arma - gëzhojat, duke pas parasysh dëshmitë e dëshmitareve të dëmtuar, por edhe mbrojtjen e të akuzuarit Fe. kjo Gjykatë vlerëson se me pa mëdyshje është vërtetuar fakti se i akuzuari ka qenë në automjet dhe ka pas në duar revole me të cilën ka shtënë në drejtim të policëve me dashje që ti privojë nga jeta, ndërsa, fakti se nuk janë shkaktuar pasoja është irelevant. Kurse konkludimi i gjykatës së në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet subjektive dhe objektive të vrasjes së rendë në tentativa është i bazuar (në fakt në rastin konkret është shkel ligji në dobi të të akuzuarit, ngase sipas rrjedhës së ngjarjes dhe përshkrimit të veprimeve inkriminuese të të akuzuarit në dispozitiv të aktgjykimit përkitazi me këtë vepër penale, përmbushen elementet e tri veprave penale të vrasjes së rendë në tentativa-neni 147 pika 10 lidhur me nenin 20 të KPK, ngase objekt sulmi në rastin konkret kanë qenë tre persona –zyrtar të policisë- mirëpo, në këtë rast gjykata ka qenë e lidhur me cilësimin e Prokurorit sepse Prokurori i ka cilësuar veprimet inkriminuese të të akuzuarit vetëm si një vepër penale.

Edhe pretendimet tjera në ankesë se gjendja faktike nuk është vërtetuar edhe për tri rastet e veprave penale të grabitjes sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara.

Sipas provave të administruara, është vërtetuar se në të tri rastet e grabitjes të kryera me 14.03.2012, i akuzuari ka vepruar së bashku me vëllain e tij -të ndjerin P.K., ashtu që të maskuar dhe të armatosur me armë, kanë shkuar te lumi Dri, tek "Ura e Shenjtë", dhe gjersa të dëmtuarit E.S., F.R. e E.Q. ishin në piknik nën kërcënimin e armëve i kanë urdhëruar që të shtrihen për tokë dhe ua kanë marrë gjësendet me perse afërmi të përshkruara si në dispozitivin nën pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të kundërshtuar, pastaj kanë urdhëruar F.R. që me veturën e tij të vozis në drejtim të restorantit "...", në fshatin ... te Rahovecit dhe me veti kanë marrë edhe personin -F.H., kur kanë shkuar tek restoranti ... rreth orës 23:00 F.R. e kanë urdhëruar që të priste në veturën e tij, kurse F.H. e kanë urdhëruar që të ecet përpara tyre dhe të hynte në restorant ta kërkonte personin me emrin Q., pastaj ata të maskuar dhe me armë në dore kanë hyrë në restorant kanë kërkuar nga të gjithë personat prezent që të shtrihen për toke dhe të nxjerrin të gjitha gjësendet me vlerë dhe pasi që i kanë marrë ato kanë urdhëruar Nj.P. që me veturën e tij t'i voziste në drejtim të fshatit ... në restorantin "...". Kur kanë shkuar tek ky restorant kanë vepruar në mënyrë të njëjte duke e urdhëruar rojën e restorantit dhe Nj. që të hynë në restorant pastaj kanë hyrë vet duke i urdhëruar që të gjithë që të shtrihen për toke dhe të nxjerrin gjësendet e vlefshme. Rezulton se gjatë marrjes së gjësendeve ka pas rezistencë ndaj tyre me ç'rast i akuzuari gjuan në drejtim të derës së restorantit ku ishte pronari R.K. i cili po ashtu me armë ka gjuajtur në drejtim të pandehurit, e edhe pronari tjetër J.K. ka gjuajtur me armë, me ç'rast vëllai i të pandehurit ka mbetur i vdekur kurse i dëmtuari R. ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Është më se evidente se të gjithë dëshmitarët – të dëmtuarit e këtyre rasteve nuk e kanë identifikuar të akuzuarin në bazë të pamjes së tij, ngase ai ishte i maskuar, por identifikimi i të akuzuarit nga pothuajse të gjithë dëshmitarët është bërë në bazë të konstruktit fizik, të folurit-dialektit dhe ngjyrës së syve. Përveq kësaj gjendja faktike përkitazi me pjesëmarrjen e të akuzuarit në kryerjen e këtyre tri veprave penale është vërtetuar edhe me prova materiale-ekspertiza e laboratorit të forenzikës në Prishtinë me numër AKF/2013-643 datë 11.03.2013, ashtu që nga dëshmia e gjetur në vendin e ngjarjes dhe atë të shishes së ujit D#1.C në çantën e të ndjerit P.K. janë bërë krahasimet e profileve të ADN dhe sipas kësaj ekspertize profili i ADN së H.K.t përputhet me njërin nga profilet e përziera të fituara nga dëshmia D#1.C, kështu që i akuzuari nuk mund të përjashtohet si kontribues i ADN në dëshminë D#1.C. Prandaj kjo Gjykatë vlerëson se mbrojtësi pa bazë pretendon se i akuzuari nuk është ekzekutor i këtyre veprave penale. Bazuar në këtë, kjo Gjykatë edhe pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit se i akuzuari me 14.03.2012 nuk ka qenë fare në Kosovë, por në Vlorë, në fakultetin "...", ngase është student i këtij fakulteti( për çka gjykatës ia ka prezantuar vërtetimin e lëshuar nga ky fakultet) i vlerëson si të pabazuara ashtu siç me të drejte ka vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë. Në fakt nga vërtetimi i prezantuar si prove del se i akuzuari është student i këtij fakulteti, por nga ky vërtetim nuk argumentohet fakti se i akuzuari ishte në fakultet pikërisht në kohën e kryerjes së veprave penale ngase veprat penale janë kryer gjatë natës prej orës 22:00.

Prandaj, kjo Gjykatë i vlerëson si të pabazuara pretendimet e mbrojtjes së gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar gjendjen e fakteve dhe në mungesë të provave e ka shpall fajtor të akuzuarin, ndërsa a është zbatuar drejt ligji penal në aspektin e cilësimit juridik të veprave penale do të jepen vlerësime në vijim.

### **c).Zbatimi i ligjit penal nga ana e Gjykatës së shkallës së parë**

Përkitazi me pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit se në veprimet e të akuzuarit nuk qëndrojnë elementet e veprës penale të vrasjes së rendë është bere fjalë me lartë në kuadër të gjendjes faktike, mirëpo, duke e shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë detyrimisht përkitazi me shkelje të ligjit penal kjo Gjykatë vlerëson se me aktgjykimin e kundërshtuar nuk është zbatuar drejt ligji penal( i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale) kur i akuzuari është shpall fajtor edhe për veprat penale lëndim i rendë trupor, nga neni 154 par.1 të KPK dhe shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK, ngase veprimet inkrimunese të këtyre veprave penale konsumohen me elementet e veprës penale të grabitjes, nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK e jo edhe në vepra penale të veçanta. Në fakt vepra penale e grabitjes nga neni 255 par.1 të KPK kryhet kur kryesi përvetëson pasurinë e luajtshme të personit tjetër me qëllim që t'i sjellë vetes apo tjetrit dobi pasurore të kundërligjshme, duke përdor dhunën apo kanosjen kundër personit tjetër se do ta sulmojë atëçastshëm jetën apo trupin e personit tjetër , kurse sipas par. 2 nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni ka të bëjë me sendin e vjedhur me vlerë që tejkalon 10.000 euro dhe nëse kryerësi ka për qëllim ta përvetësojë sendin me vlerë të tillë, kryerësi dënohet me së paku tre vjet burgim, kurse sipas par.3 nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga kryerësi duke vepruar si anëtare i grupit

ose duke përdorë ndonjë armë a mjet të rrezikshëm, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në dymbëdhjetë vite.

Nga dispozitivi nën pikën V i aktgjykimit të kundërshtuar rezulton se i akuzuari bashke me vëllain e tij gjatë kryerjes së grabitjes me 14.03.2012 rreth orës 23:00 në kafiterin “...” pronarët e kafenesë kanë rezistuar me ç’rast i akuzuari gjuan në drejtim të derës së kafenesë ku ishte pronari R.K. i cili po ashtu me armë ka gjuajtur në drejtim të pandehurit, e edhe pronari tjetër J.K. me ç’rast vëllai i të pandehurit ka mbetur i vdekur kurse i dëmtuari R. ka pësuar lëndime të rënda trupore, prandaj kjo Gjykatë vlerëson se në veprimet e të akuzuarit përmbushen vetëm elementet e veprës penale të grabitjes nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK e jo edhe veprave penale lëndim i rëndë trupor dhe shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm siç gabimisht i ka ngarkuar me akuzë prokurori dhe vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë.

Në fakt në rastin konkret në veprimet e të akuzuarit përmbushen elemente e veprës penale rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes, nga neni 256 par.1 të KPK(formë me rëndë kjo e vjedhjes grabitqare dhe grabitjes, nëse rezulton me lëndime të rënda trupore ,ose nëse kryhet nga një grup i armatosur), mirëpo, pa marrë parasysh se këto veprime të akuzuarit Prokurori nuk i ka inkriminuar konform ligjit penal, ai nuk ka mundur as që ti inkriminojë këto veprime në kuadër të tri veprave penale, ndërsa, meqë është në kompetencë të Prokurorit ti cilësojë veprimet inkriminuese dhe gjykata nuk është e lidhur me cilësimi juridik të veprave penale sipas vlerësimit të kësaj Gjykate edhe gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar gabimisht në këtë drejtim prandaj, detyrimisht e ndryshoj aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me cilësimin juridik në pajtim me ligjin penal sikurse në pikën I të dispozivit të këtij aktgjykimi.

#### **ç). Pretendimet ankimore sa i përket vendimit për dënim**

Prokurori Themelor në Gjakovë sa i përket vendimit për dënim pretendon se dënimi i shqiptuara me burg ndaj të akuzuarit nuk i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, dhe se me dënimin e shqiptuar nuk do të mund të arrihet qëllimi i dënimit. Kështu, sipas ankesës së Prokurorit gjykata nuk i ka vlerësuar rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale, i akuzuari ka tentuar të privojë nga jeta zyrtarët policor, ka kryer tri grabitje të njëpasnjëshme, madje duke marrë edhe persona peng dhe duke iu shkakuar edhe lëndime të rënda trupore. Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e tij nuk konteston aktgjykimin sa i përket vendimit për dënim dhe as që thekson në këtë drejtim ndonjë fjalë.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e Prokurorit për dënim me të ashpër janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka vlerësuar rrethanat familjare, se në kohën e kryerjes së veprave penale ishte në moshës relativisht të rë, kurse, rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Vlerësimin e tillë të rrethanave lehtësuese e pranon edhe kjo Gjykatë, mirëpo, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka anashkaluar rrethanat rënduese siç janë: i akuzuari brenda një nate ka kryer tri vepra penale të grabitjes, vendet ku janë kryer këto vepra penale (restoranti ... ishte i mbushur me njerëz - dëgjohej muzikë), mënyra e kryerjes duke marrë njerëz me vete prej një vendi në tjetrin, frika që ju është shkaktuar të pranishmëve – të dëmtuarve, por edhe indinjata e shkaktuar tek popullata e këtij rajoni, pavarësisht ricalësimit të veprave penale sikurse në pikën I të këtij dispozitivi kjo Gjykatë konsideron se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk është adekuat me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, prandaj, e aprovoj ankesën e Prokurorit dhe të akuzuarit i shqiptoj dënimin me burg sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit, dhe se me të do të mund të ndikohet në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij, por edhe në parandalimin e të tjerëve nga kryerja e veprave penale, dhe do të forcojë moralin dhe detyrimin e shoqërisë për respektimin e ligjit, respektivisht do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK. Pavarësisht asaj që mbrojtësi i të akuzuarit nuk e arsyeton vendimin për dënim kjo Gjykatë për arsytet e lartcekura konsideron se nuk ka vend që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim me i butë.

Meqë, kjo Gjykatë për arsytet e theksuar me lart ka gjet se veprimet inkriminuese të të akuzuarit H.K. sa i përket veprës penale lëndim i rendë trupor përfshihen në kuadër të veprës penale të grabitjes, ankesa e të dëmtuarit nuk mund të trajtohet si e lejuar. Ngase i dëmtuari sipas dispozitës së nenit 381 par.3 të KPP ka të drejtë të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale.

Kjo Gjykatë e shqyrtoj e vlerësoj edhe ankesën e të akuzuarit të cilën kjo Gjykatë e ka pranuar me 30.09.2014 dhe gjeti se ajo është e pas afatshme. Kështu nga shkresat e lëndës del se i akuzuari aktgjykimin e shkallës së parë e ka pranuar me 21.08.2014, kurse ankesën e ushtruar e ka dorëzuar në postë me 28.09.2014.

Duke shqyrtuar datën e pranimit të aktgjykimit nga ana e të akuzuarit dhe atë të dorëzimit të ankesës në postë, rezulton se ankesa është paraqitur pas afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditor prej marrjes së aktgjykimit, për kundër asaj që palët kanë pas drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, ashtu siç është paraparë me dispozitën e nenit 380 të KPP.

## II

Siç del nga shkresat e lëndës ndaj të akuzuarit H.K. janë ngritur dy aktakuza dhe me këto akuza është akuzuar edhe për dy vepra penale - mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 374 par.1 të KPK. Në seancën e shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës përfaqësuesi i akuzës ka deklaruar “pas leximit

të aktakuzës PP.nr.80/13, PP.nr.101-414/2010 PE-1 datë 4.08.2013, pasi që ndërkohë ka hyrë ligji mbi amnistinë sa i prekët veprës penale nga neni 374 par.1 të KPK në pikën II ndaj të akuzuarit H.K. PP.nr.101-412/2010 PE, po ashtu hjeku dore ndaj të akuzuarit H.K. PP/.nr.80/13 në pikën 6 të kësaj aktakuze për veprën penale nga neni 374 par.1 të KPK ndërsa në pjesët tjera mbes në tersi pranë tyre”.

Ndërsa, ne seancën e shqyrtimit gjyqësor rezulton se akuzën e ka përfaqësuar një tjetër Prokuror dhe ky Prokuror në fjalën hyrëse ka deklaruar “ Prokurori paraprak i cili ka marrë pjesë në shqyrtimin fillestar ka bërë një lëshim ashtu që ka heq dorë nga aktakuza ndaj të akuzuarit për këtë vepër penale dhe njoftoj trupin gjykues se tërhiqmi nga heqja dorë për këtë vepër penale dhe se e njëjta të vazhdoj të jetë çështje dhe objekt i shqyrtimit në këtë shqyrtim gjyqësor”.

Duke pas parasysh këtë gjendje të çështjes përkitazi me këto vepra penale kjo Gjykatë vlerëson se Prokurori nuk ka pas të drejtë të tërheq deklaratën e Prokurorit paraprak mbi heqjen dore nga akuza për këto vepra penale dhe as që Gjykata ka mund ta shpall fajtor të akuzuarin për këto vepra penale, ngase konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 292 par.1 të KPP Prokurori i Shtetit mund ta tërheq aktakuzën para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, nëse paraqet njoftimin për tërheqjen nga aktakuza, kurse sipas par.2 të të njëjtit nen aktakuza e tërhequr nuk mund të paraqitet serish nga Prokurori i Shtetit, prandaj, meqë Prokurori ka heq dorë nga akuza për këto vepra penale në shqyrtimin fillestar pra, para fillimit të shqyrtimit gjyqësor kjo Gjykatë vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e refuzuar akuzën konform dispozitës së nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPP për këto vepra penale.

### III

#### **Vlerësimi i gjykatës përkitazi me pjesën liruese të aktgjykimit të kundërshtuar**

Duke e vlerësuar aktgjykimin e kundërshtuar në pjesën liruese kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorit për këtë pjesë të çështje nuk janë të bazuara. Edhe pse me ankesën e Prokurorit vetëm theksohet se aktgjykimi në këtë pjesë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk konkretizon se ku qëndrojnë këto shkelje, ndërsa pretendimet në këtë drejtim I referohen gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal.

Megjithatë Gjykata e Apelit e shqyrtoj aktgjykimin e kundërshtuar në këtë pjesë sipas detyrës zyrtare dhe gjeti se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij.

Përkitazi me gjendjen faktike me ankesë vetëm kontestohen konkludimet e gjykatës në bazë të provave të administruara. Kështu, pretendohet se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt gjendjen faktike, mirëpo, bazuar në faktet e vërtetuara konkludimi i saj se nuk është provuar se i akuzuari F.B. ka kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nga neni 316 par.3 të KPK nuk është i bazuar. Kështu, sipas ankesës së Prokurorit edhe pse gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktin se i akuzuari Fe.

ka qenë së bashku me të akuzuarin H.K. në momentin kur policët zyrtar kanë kërkuar që të ndalte automjetin të cilin e voziste i akuzuari Fe. ai nuk është ndalur në vend por pas 6-7 m dhe në këtë mënyrë ia ka mundësuar të akuzuarit H. që të arratisë, përveç kësaj sipas ankesës i akuzuari F. ka qenë bashkëpunëtor i të akuzuarit H. dhe edhe pse nuk ka pranuar se njih provat flasin të kundërtën – vërtetojnë faktin se i akuzuari Fe. e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykatë pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara. Sipas dispozitës së nenit 316 par.1 të KPK vepra penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare kryhet atëherë kur me dhunë apo me kanosje për përdorim të atëçastshëm të dhunës pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare që bie në fushëveprimin e kompetencave të tij ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyra zyrtare, kurse par.3 është formë e cilësuar e veprave penale të parashikuara nga paragrafi 1 dhe 2 dhe ekziston kur vepra penale e parashikuar nga par. 1 dhe 2 është kryer ndaj personit zyrtar: gjatë kryerjes së sigurimit publik apo sigurisë shtetërore të Kosovës, gjatë ruajtjes së rendit publik ,gjatë burgosjes së kryerësit të veprës penale ose gjatë ruajtjes së personit të privuar nga liria.

Sipas shkresave të çështjes dhe provave të administruara nuk është kontestuese se i akuzuari F.B. me 25.09.2010 rreth orës 22:00 në automjetin të cilin ai e drejtonte kishte të akuzuarin H.K., dhe se me rastin e dhënies se shenjës për tu ndalur nga ana e policisë nuk e ka ndaluar automjetin.

Kontestues është fakti se a përmbushen në veprimet e të akuzuarit elementet e veprës penale, nga neni 316 par.3 lidhur me par.1 të KPK për të cilën ai është akuzuar, pra, a e përdori ai dhunën apo kanosjen për përdorim të atëçastshëm të dhunës dhe i pengoi personat zyrtar duke ua pamundësuar kryerjen e detyrave zyrtare.

Duke pasur parasysh elementet e kësaj vepre penale që duhet të përmbushën për ekzistimin e kësaj vepre penale dhe veprimet që i ka ndërmarre ky i akuzuar kjo Gjykatë vlerëson se në veprimet e tij nuk përmbushen elementet e kësaj vepre penale, ngase format e ndryshme të qëndrimit pasiv të kryesit d.m.th mosveprimi në drejtim të pamundësisë së kryerjes së detyrës zyrtare nuk paraqesin veprim kryes të kësaj vepre penale. Fakti se i ky i akuzuar kishte në automjet të akuzuarin H. nuk nënkupton se ai e ka kryer këtë vepër penale ashtu siç pretendon prokurori ( cilësimin e kësaj vepre penale e ka bërë vet prokurori dhe në këtë rast i akuzuari nuk ngarkohet për bashkëpunim me të akuzuarin H.K.), ngase, sipas dëshmisë së zyrtarëve policor ata nuk kishin njohuri se në automjet ishte i akuzuari H.K., por, ata po vepronin në njësinë e patrullimit sipas planit operativ "goditje e hekurt", më qëllim të parandalimit të gjerave negativë ne shoqëri, kurse sipas dëshmisë se tyre automjeti të cilin e ka vozitur i akuzuari Fe. pas sinjalizimit që të ndalet nuk është ndalur, ndërsa, është ndalur pas 5-6 m, por, pas ndaljes vozitësi ka qëndruar në automjet dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ne drejtim të tyre.

Vlen të theksohet se as me ankesë nuk theksohet ndonjë provë që e ve në dyshim gjendjen e fakteve, por vetëm kontestohet vlerësimi i provave nga gjykata, duke pretenduar

se është dashtë të merret konkludim tjetër(gjykues), mirëpo, për arsyet e lartcekura kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet ankimore në këtë drejtim nuk janë të bazuara dhe se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza dhe se drejt e ka aplikuar edhe ligjin penal.

#### IV

Aktgjykimi në pjesën refuzuese nuk është kundërshtuar me ankesë prandaj në këtë pjesë ngel i pashqyrtuar.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 403 e 402 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË  
PAKR.nr.461/2014, me 21 tetor 2014

Procesmbajtësi,  
Eroll Gashi

Kryetarja e kolegjit  
1. Fllanza Kadiu

Anëtarët e kolegjit:

2. Mejreme Memaj

3. Fillim Skoro